

## **AKT THEMELIMI**

i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar  
**"KOMPANHIA GERAL "sh.p.k.**

Sot, me date 18/10/2023, u paraqiten personalisht :

1) Rui Lis Nogueira Falcao de Campos i biri i Falcao de Campos, lindur në Santarem, Portugali më 10.08.1960, shtetas portugez mbajtës i letërnjoftimit me nr. CB204134, me leje qendrimi ne shtetin shqiptar paisur me Nr Personal G03810006T me adrese: kompleksi Square 21 SH1, K9, AP 62 madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar

periplohet ky Akti Themelimi si vijon:

### **Neni 1 ORTAKET THEMELUES**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**KOMPANHIA GERAL " Sh.p.k.**" themelohet nga ortakët ;

1) Rui Lis Nogueira Falcao de Campos i biri i Falcao de Campos, lindur në Santarem, Portugali më 10.08.1960, shtetas portugez mbajtës i letërnjoftimit me nr. CB204134 madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar

### **Neni 2 PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqeria "**KOMPANHIA GERAL " Shpk**" do të jetë person juridik shqiptar. Kjo do të fitojë personalitetin juridik kur të regjistrohet pranë Qendres Kombetare të Biznesit të Shoqerive Tregtare, ndërsa veprimtarinë ekonomike do të fillojë pasi të pajiset me lejen perkatese nga organet kompetente.

Veprimtaria e Shoqerise do të rregullohet sipas dispozitave të këtij akti themelimi, Statutit bashkalidhur dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

### **Neni 3 SELIA**

Shoqeria "**KOMPANHIA GERAL " sh.p.k.**" do të ketë seline në Republikën e Shqipërisë, Rruga Mine Peza, Hyrja -1 Zone Kadastrale 8350, Numer Pasurie 2/369-N6, Volum 39, faqe 237, Tirane 1001

### **Neni 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarisë të Shoqerise "**KOMPANHIA GERAL " Sh.p.k**" do të jetë :  
**"Sherbime të ndryshme për fillimin e veprimtarive ekonomike, sherbime mbeshtetese për turistët dhe rezidentët e huaj"**

Veprimtaria e shoqerise do të jetë për një afat të pacaktuar

### **Neni 5 KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali i shoqerise përbehet vetëm nga kontributi në para, në shumën 600000 (gjashtëqindmijë) leke.

1. Ortaku themelues: Rui Lis Nogueira Falcao de Campos: zoterues i 1 (nje) kuote me vlere 600000 (gjashteqindmije) leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise;

#### **Neni 6**

### **FONDET E SHOQERISE**

Shoqeria do te krijojë fondet perkatese, te cilat do te specifikohen ne Statutin e Shoqerise dhe do te mbahen ne Librin e caktuar per kete qellim.

#### **Neni 7**

### **NDARJA E FITIMIT TE SHOQERISE**

Fitimi neto qe do te realizohet nga shoqeria, d.m.th. qe do te mbetet pas shlyerjes te te gjitha detyrimeve dhe pas vecimit te fondeve te detyruara, do t'i kaloje ortakeve.

#### **Neni 8**

### **PERGJEGJESITE E ORTAKEVE**

Ortaketjane pergjegjes kundrejt te treteve per pasojat dhe demet qe rrjedhin nga anulimi ose deklarimi i pavlefshem i aktit te themelimit te shoqerise.

Po ashtu, ortaket jane pergjegjes ne masen 100 % edhe per te gjitha humbjet qe mund te rezultojne gjate aktivitetit ekonomik te shoqerise.

#### **Neni 9**

### **DISPOZITE E PERGJITHESHME**

Problemet e kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative, transferimi i kapitalit, zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit, menyra e administrimit te shoqerise, emerimi i administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, kompetencat dhe pergjegjesite e tyre, menyra e mbajtjes se llogarive, falimentimi dhe humbja e kapitalit themeltar, shnderrimi i shoqerise, zgjidhja e mosmarrveshjeve dhe problemet e tjera qe lidhen me veprimtarine e shoqerise do te zgjidhen sipas dispozitave te Statutit te Shoqerise dhe, ne mungese te tyre, nga legjislacioni ne fuqi.

Ky akt themelimi, u hartua ne baze te vullnetit te lire te ortakeve, hartohet ne 3 ekzemplare.

Per sa me siper ju lexua me ze te larte dhe te qarte ortakeve dhe meqense ajo shpreh vullnetin e tyre, neneshkruhet pa verejtje.

### **ORTAKET E SHOQERISE**